




REPUBLIC OF KOSOVO	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-669/13
Nr. Prot. 02	06.03.2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.01.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2426/12, për ztr. *Abdyl Hasani* – Kryesues i Bordit të Kompanisë Rajonale “Hidromorava” Gjilan, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin me numër protokoli AKK-02-2405/12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Abdyl Hasani – Kryesues i Bordit të Ujësjetës Rajonal “Hidromorava”, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së paraparë ligjore të shqyrtimit, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051), kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari Abdyl Hasani (Kryesues i Bordit të Kompanisë Rajonale “Hidromorava”) nuk ka pozitë menaxhuese as aksione të pronësisë në ndërmarrjen private “Bejta Commerce” sh.p.k., siç është dyshuar.

Ztr. Hasani në takim me zyrtarët e Agjencisë ka dëshmuar se ai është vetëm një nga të punësuarit në këtë ndërmarrje. Po ashtu nga informacionet zyrtare nga ARBK-ja lidhur me këtë biznes, shihet qartë se ky biznes është në pronësi dhe menaxhim të dikujt tjetër, kurse ztr. Abdyl Hasani – Kryesues i Bordit të Kompanisë Publike “Hidromorava”, nuk ka kurrfarë pozite vendimarrëse në kompaninë private.

Ndërsa, lidhur me faktin se kompania private në fjalë ka fituar tender nga "Hidromorava", kjo varet nga procedurat e tenderimit dhe si e sa janë përfilluar ato, për të cilat ztr. Hasani nuk ka kompetencë as rol vendimmarrës.

Por, megjithatë vetëm për të mos krijuar dyshim për ndonjë situatë të konfliktit të mundshëm të interesit, Ztr. Hasani ka deklaruar se me rekomandimin e tij, një kontratë e më hershme që ka qenë mes këtyre dy subjekteve, është ndërprerë në prill të vitit 2012, dhe krejt kjo me qëllim të parandalimit të dyshimeve për ndonjë konflikt të mundshëm të interesit.

Në bazë të dokumentit zyrtar të nxjerr nga Agjensioni për regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), dhe deklaramenteve të ztr. Hasani kemi konstatuar se nuk ka elemente të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit


/ Hasan Preteni /

